

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot me date 23.09.2022 (dymijenzëzet e dy), lidhet kjo kontrate e shitje se kuotave te pjesëmarrjes ne kapitalin e regjistruar te shoqërisë "FA ALBANIAN INVESTIMENT" sh.p.k te pajisur me NUIS L86623202I me seli ne Vlore, Rruga "11 Janari", Objekt 1 Katesh Godina Nr. 99, midis palëve si me poshtë:

SHITES; Z. Andi Gezim Baku, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 04.06.1989, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, identifikuar nëpërmjet Letërnjoftim ID Nr. Personal I90604051G, madhor, me zotësi te plote juridike dhe për te vepruar.

BLERES; Z. Fitim Qani Goxhaj, shtetas Shqiptar, lindur me 19.07.1953 ne Selenice Vlore dhe banues Vlore, ne e, madhor e me zotësi te plote juridike dhe për te vepruar, mbajtës i letërnjoftimit Nr. Personal F30719045O

BAZA LIGJORE; Referuar dispozitave ligjore: -Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar. -Ligji Nr.9723 date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare Te Regjistrimit" me ndryshimet e mëvonshme. -Kodi Civil. - Akt Themelimi dhe Statuti i Shoqërisë.

OBJEKTI; Shitje e tërësisë se kuotave te zotëruara nga shitësi, z. Andi Baku, zotëruar i 1 (një) kuote qe korrespondon me 50 % te kapitalit themeltar ne shoqërinë tregtare "FA ALBANIAN INVESTIMENT" sh.p.k. pajisur me NUIS L86623202I te blerësi, ortaku tjetër i shoqërisë, z. Fitim Goxha kundrejt vlerës totale 50.000 leke.

Me hartimin dhe nënshkrimin e kësaj Kontrate Z. Andi Baku humb tërësisht te drejtat e pronësisë mbi kuotën e zotëruar nga ana e tij si dhe çdo te drejte reale qe buron nga zotërimi i kuotës deri me tani apo dhe detyrimet e tij me këtë shoqëri, pronësi e cila, me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimit e saj ne QKB kalojnë plotësisht te Zoti, Fitim Goxhaj se bashku me te drejtat dhe detyrimet qe ajo mbart kundrejt vlerës totale 50.000 leke. Çmimi i kuotës 50.000 leke ka parasysh faktin qe shoqëria nuk ka pasuri, nuk ka kryer aktivitete dhe ka detyrime fiskale te pa likuiduara, detyrime te cilat merren përsipër te likuidohen nga blerësi i kuotës zoti Fitim Goxhaj pa renduar apo kërkuar pagese shtese nga zoti Andi Baku.

Shitësi Andi Baku deklaroi se ka marre pagesën e shitjes se kuotave dhe me nënshkrimin e kësaj kontrate palët nuk kane me detyrime te pa likuiduara me njeri tjetrin.

Me shitjen e kuotave te shoqërisë shitësi Andi Baku deklaroi se jep dorëheqjen dhe nga detyra e Administratorit te shoqërisë duke mundur kështu emërimin e administratorit te ri nga ortaku Fitim Goxhaj si ortak i vetëm i saj qe mbetet mbas largimit ligjorisht te ortakut Andi Baku.

Mbas nënshkrimit te kësaj kontrate dhe pasqyrimit e saj ne QKB, Shoqëria tregtare "FA ALBANIAN INVESTIMENT" sh.p.k. te pajisur me NUIS L86623202I pëson këto ndryshime:

Ishte: Shoqëria tregtare "FA ALBANIAN INVESTIMENT" sh.p.k. e pajisur me NUIS L86623202I, me kapital themeltar 100 000 leke dhe i përberë nga dy kuota te zotëruara nga ortakët Z. Andi Baku zotëruar i 1 (një) kuote me vlere 50% te kapitalit ne Shoqërisë dhe Z. Fitim Goxhaj, zotëruar te 1 (një) kuote ne masën e 50% te kapitalit themeltar .

Behet: Shoqëria tregtare "FA ALBANIAN INVESTIMENT" sh.p.k. pajisur me NUIS L86623202I me kapital themeltar 100 000 leke e përfshirë ne një kuote qe përfaqësojnë 100% te kapitalit te saj themeltar dhe e zotëruar nga Ortaku i Vetëm Z. Fitim Goxhaj, tashme zotëruar te 1 (një) kuote ne masën e 100% te kapitalit themeltar te shoqërisë.

Duke qene se te dy ortakët pjesëmarrës ne këtë kontrate te shitjes se kuotave janë dhe te vetmit ortak themelues te shoqërisë kjo kontrate mbarte dhe vullnetin e tyre si një vendim te asamblesë se ortakeve.

Ortaku Fitim Goxhaj, si ortak i vetëm i shoqërisë mbas regjistrimit te kësaj kontrate merr detyrimin për aplikimin e kësaj kontrate ne ashk si dhe ne portalin e pronareve përfitues duke bere pasqyrimet përkatëse dhe ndryshimin e te dhënave te shoqërisë.

Kjo Kontrate u përpilua në katër kopje me vlere te njëjte ligjore, e cila pasi lexohet prej palëve te interesuara me zë te lartë e te qartë, kuptohet prej tyre, deklarohet se u gjet e përpiluar ne përputhje me vullnetin e tyre te lire e te plote si dhe me Ligjin e për rrjedhojë u nënshkrua rregullisht prej tyre si me poshtë.

SHITESI

Andi Gezim Baku

FA ALBANIAN
INVESTIMENT
L86623202I

BLERESI

Fitim Qani Goxhaj

Fitim Qani Goxhaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË
DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR”**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L86623202I	
2. Data e Regjistrimit	23/04/2018	
3. Emri i Subjektit	FA ALBANIAN INVESTIMENT	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	17/04/2018	
6. Kohëzgjatja	Nga: 17/04/2018	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Vlore Vlore VLORE Lagjja Kushtrimi, Rruga 11 Janari, Objekt 1-Katesh Nr.99	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00	
9. Objekti i aktivitetit	Ndertim i te gjitha llojeve si banesa qytetare, ndertime industriale dhe tregtare, komplekse turistike, autostrada, kanalizime, vepra te tjera te energjise se rinovueshme. Punime hekuri, ndertime armaturash, shtrim pllakash, berje mure tulle dhe beton arme, instalime elektrike e hidraulike. Import-eksport, tregti me shumice e pakice e artikujve te ndryshem ushqimore, industrial, materiale ndertimi, pjese kembimi etj.	
10. Administratori/ët	Andi Baku	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 17/04/2018	Deri: 17/04/2022
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	AndiBaku	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	SHENIME.pdf
21/09/2020	<p>Numri i ceshtjes: CN-590971-09-20 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i Kërkesës Nr. 5205 Prot, datë 29.06.2020, “Kërkesë për vendosjen e masës së sigurimit tatimor”, ardhur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, Bashkia Vlorë, ku është kërkuar: Vendosja e Barrës Siguruese mbi titujt e pronësisë së tatimpaguesit “FA ALBANIAN INVESTIMENT”, pajisur me NUIS (NIPT) L86623202I, duke moslejuar tjetërsimin mbi pasurinë dhe të drejtat pasurore që i përkasin këtij subjekti.</p> <p><u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>Vendimi/Akti i Gjykatës, Zyrës Përmbartimore ose Autoritet tjetër publik</u></p>

Datë: 09/09/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2022/09/09 11:30:44 +02:00
L86623202I20220909113018133
006